



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.P. "ARDI"

Nr. i biznesit 80198582

Pronar – Ymer KURTOLLI

OK "NTP ARDI"

Rr/ Zahir Pajaziti p.n.

Podujevë

Ref: 1501/036/LIC/ni

### VENDIM

për licencimin e Operatorit Kabllor, "NTP ARDI", me seli në Podujevë

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kandidati për operator kabllor "NTP ARDI", ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operator kabllor, më datën 12 janar 2015.

#### Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".
5. KPM, kandidatit për licencë për operator kabllor "NTP ARDI", i ka përcjellë përmesë e-maili, perveq rregulloreve relevante të KPM-së për aplikim për licencë si: Rregulloren e KPM-së për Dhënien e Licencës (KPM-2013/04), Rregullorën për Nivelin dhe Mënyren e Pagesës së Tarifës për Licencë (KPM-2014/03), Rregullores për Distribimin Kabllorë të

Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC-2007/04) dhe Formën për aplikim për licencë për operator kabllor.


6. KPM vlerëson se, kandidati “NTP ARDI”, ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores CIMC 2007/04.
7. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj, KPM vlerëson se, një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve, ndërsa kandidati “NTP ARDI” ka dorëzuar një listë prej 27 programesh.
8. Kandidati për operator kabllor “NTP ARDI”, do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij programore vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllorë.
9. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator kabllor “NTP ARDI” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në rrjetin e tij kabllorë, ai mund të të zgjerojë listën e programeve në të ardhmen. Kandidati “NTP ARDI”, obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
10. KPM vlerëson se, “NTP ARDI”, ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren KPM-2013/04.
11. KPM vlerëson se, kandidati për operator kabllor “NTP ARDI”, ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### Vendim

12. Në takimin e datës 24 shkurt 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit të interesuar për licencë të operatorit kabllorë “NTP ARDI” i cili planifikon të operojë në disa fshatra të Komunës së Podujevës, t’ia miratojë kërkesën për licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime të programeve përmes operatorit kabllor.

### Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.



Adnan MERQVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.02.2015

datë